



Informacion për prindërit:

Rëndësia e të lexuarit për fëmijën

Një fëmijë që lexon...

1. do të rritet me më shumë vetëbesim dhe do të jetë më social në një ambient grupi

Sipas hulumtimeve, fëmijët që lexojnë rregullisht janë më të ndërgjegjshëm dhe empatikë nga ana sociale dhe shkojnë më mirë me të tjerët në një grup.

2. do të ketë një fjalor shumë më të gjerë

Studimet tregojnë se deri në moshën tre vjeç, fëmijët në familjet që lexojnë kanë dëgjuar 20 milionë fjalë më shumë sesa fëmijët në familjet që nuk lexojnë. Një fjalor më i gjerë e bën më të lehtë për një fëmijë që të jetë në gjendje të shprehet.

3. do të jetë më i suksesshëm në shkollë

Një fëmijë që ka marrë njohuri nga tregimet dhe vjershat përpara se të fillojë shkollën, rritet dhe arrin më shumë në shkollë sesa një fëmijë që nuk lexon.

4. do të ketë një nisje më të mirë të jetës

Sipas hulumtimeve, suksesi i ardhshëm i një fëmije në jetë ndikohet më shumë nga fakti se sa fëmija lexon sesa nga niveli socio-ekonomik i prindërve.

5. flasë më shumë në shtëpi

Leximi me zë për fëmijën tuaj forcon marrëdhëniet familjare. Familjet që lexojnë shumë libra bisedojnë më shumë së bashku. Përmes tregimeve, mund të diskutohet për ngjarjet e përditshme, dhe kthesat më të mëdha në jetë mund të kuptohen dhe trajtohen më lehtë.

6. do të zhvillohet në një të rritur më aktiv dhe të orientuar drejt objektivave


Të rriturit aktivë, kureshtarë dhe të orientuar drejt objektivave kanë lexuar më shumë se zakonisht gjatë fëmijërisë së tyre dhe vazhdojnë të lexojnë më shumë libra si të rritur. Ata janë në gjendje që të shprehin më lehtë mendimet dhe të arrijnë objektivat e tyre.



Rëndësia e gjuhës amtare

Gjuha amtare është gjuha e emocioneve të një personi. Kur një prind i lexon në gjuhën e tij amtare fëmijës së tij, kjo ndihmon për të krijuar një lidhje të fortë midis prindit dhe fëmijës, si dhe për të ndërtuar fjalorin me të cilin fëmija do të jetë në gjendje që të shprehë ndjenjat e veta - një pjesë thelbësore e shëndetit mendor dhe emocional.

Një libër është i përshtatshëm për të gjitha moshat



Leximi me zë është investimi më i mirë për të ardhmen e një fëmije

Themeli për kompetencën dhe entuziazmin e një fëmije për leximin krijohet herët në fëmijëri. Ndikimi i prindërve për shkrim e këndim të fëmija i tyre është më i rëndësishëm përpara se fëmija të mund të lexojë vetë.

një i sapolindur është një dëgjues vigjilent

Zërat e njohur të anëtarëve të familjes me ritmet dhe kadencën e tyre të ndryshueshme ushqejnë ndjenjën e gjuhës së një fëmije. Një gjuhë e pasur amtare është dhurata më e mirë e mundshme për një foshnjë.

një 6-vjeçar fillimisht interesohet për librin si lodër

Fëmija i mban erë, e shijon dhe luan me librin. Personazhet e thjeshta dhe ngjyrat e ndritshme të një libri me fletë kartoni janë tërheqëse.

një 1-vjeçari i pëlqen koha e tregimit të përditshëm

Vjershat dhe poemat ritmike mbështesin zhvillimin e të folurit të një fëmije. Një tregim i shkurtër ose ninullë e qetëson fëmijën përpara gjumit.

një fëmijë 2-3 vjeç kap fjalë të reja

Kohët e tregimit bëhen ndërvepruese kur i rrituri e pyet fëmijën se çfarë po ndodh në figurat e librit. Sapo aftësia e fëmijës për t'u përqendruar të jetë përmirësuar, është koha që të kaloni nga librat me fletë kartoni te librat me figura.

një fëmijë 4-5 vjeç fillon të mësojë ABC-në e jetës nga tregimet

Tregimet e lejojnë fëmijën që ta ndiejë frikën në mënyrë të sigurt dhe të njohë emocione të ndryshme. Vjershat dhe poemat e nxisin fëmijën që të luajë vetë me gjuhën.

një 6-vjeçar tashmë fluturon në krahët e imagjinatës

Tani fëmija ka durimin edhe për një tregim më të gjatë. Diskutimet mbi ato që janë lexuar u japin kënaqësi edhe të rriturve. Tregimet e rrëfyera nga fëmijëria e një prindi mund të ndihmojnë për të nxitur krenarinë kulturore dhe për të krijuar një kohë tregimi të veçantë për prindin dhe fëmijën.

një 7-vjeçar fillon të marrë përgjegjësinë për librat në mënyrë të pavarur

Fëmija interesohet për letrat dhe tashmë dëshiron të lexojë vetë. Të mësuarit për të lexuar është një moment historik që ia vlen të festohet. Kohët e tregimit midis të rriturit dhe fëmijës vazhdojnë të jenë të rëndësishme për fëmijën për një kohë të gjatë.




Nuk është asnjëherë shumë herët që të filloni të lexoni për fëmijën tuaj!

Një seancë leximi mund të jetë një kohë cilësore qetësuese për të gjithë familjen!



Ju mund të lexoni për fëmijën tuaj në çdo kohë dhe kudo!



Të pasurit të shumë librave në shtëpi i jep mundësinë fëmijës suaj që të lexojë më shumë!

Një tregim për të fjetur mund të jetë një mënyrë e mirë për ta ndihmuar fëmijën që të qetësohet para gjumit.

